


# Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për Banesa

## Tremujori II, 2020

**Tiranë, më 03 Shtator 2020:** Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, në tremujorin e dytë 2020 arriti 104,2, duke shënuar rritje me 0,4 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2019.

Krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, indeksi i grupit “Kosto të tjera” u rrit me 1,9 %, ndjekur nga indeksi i grupit “Shpenzime transporti” me 1,7 % dhe indeksi i grupit “Shpenzime makinerie” me 1,0 %. Ndërsa, ulje kanë shënuar grupet “Shpenzime materiale” me 1,2 % dhe “Shpenzime për paga” me 1,0 %.

**Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim për Banesa**



**Në tremujorin e dytë 2020, ndryshimi tremujor i indeksit të kushtimit në ndërtim shënoi ulje me 0,1 %.** Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020, ulje kanë shënuar grupet “Shpenzime për paga” me 1,1 %, si dhe “Kosto të tjera” dhe “Shpenzime materiale” me 0,7 % secili. Ndërsa, rritje kanë shënuar grupet “Shpenzime makinerie” me 1,0 %, dhe “Shpenzime transporti” me 0,2 %.

**Për publikim 03/09/2020**

**Tab. 1 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për Banesa**

Tremujori i parë 2011=100

Kodi	Grupet	Peshat	II-17	III-17	IV-17	I-18	II-18	III-18	IV-18	I-19	II-19	III-19	IV-19	I-20	II-20
	<b>Totali (1+2+3+4+5+6)</b>	<b>100,0</b>	<b>103,0</b>	<b>103,1</b>	<b>103,2</b>	<b>103,4</b>	<b>103,5</b>	<b>103,6</b>	<b>104,2</b>	<b>103,8</b>	<b>103,8</b>	<b>103,7</b>	<b>104,1</b>	<b>104,3</b>	<b>104,2</b>
1	<b>Shpenzime materiale (a+b+c)</b>	<b>55,2</b>	<b>102,8</b>	<b>103,1</b>	<b>103,0</b>	<b>102,3</b>	<b>102,0</b>	<b>102,5</b>	<b>102,4</b>	<b>101,9</b>	<b>101,7</b>	<b>101,5</b>	<b>101,5</b>	<b>101,3</b>	<b>100,5</b>
	a. Materiale ndërtimi	42,3	103,3	103,5	103,6	102,9	102,2	102,8	102,7	102,2	101,8	101,4	101,5	101,2	100,1
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	6,7	101,0	102,3	101,1	100,5	100,9	100,8	101,0	100,2	101,9	102,4	102,5	101,6	101,4
	c. Materiale hidro-sanitare	6,2	101,4	101,1	100,4	100,3	101,7	102,3	102,2	101,4	101,1	101,0	100,9	101,5	102,2
2	<b>Shpenzime për paga</b>	<b>24,6</b>	<b>108,7</b>	<b>108,7</b>	<b>109,6</b>	<b>109,4</b>	<b>109,4</b>	<b>109,6</b>	<b>110,8</b>	<b>110,7</b>	<b>110,3</b>	<b>110,9</b>	<b>111,4</b>	<b>110,4</b>	<b>109,2</b>
3	<b>Shpenzime makinerie</b>	<b>8,3</b>	<b>102,8</b>	<b>102,8</b>	<b>102,8</b>	<b>102,3</b>	<b>102,5</b>	<b>102,6</b>	<b>103,4</b>	<b>103,4</b>	<b>103,4</b>	<b>103,3</b>	<b>104,2</b>	<b>103,4</b>	<b>104,5</b>
4	<b>Shpenzime transporti</b>	<b>5,3</b>	<b>97,8</b>	<b>97,8</b>	<b>98,0</b>	<b>99,9</b>	<b>100,1</b>	<b>100,2</b>	<b>99,9</b>	<b>98,9</b>	<b>99,5</b>	<b>98,6</b>	<b>100,2</b>	<b>101,0</b>	<b>101,2</b>
5	<b>Shpenzime për energji</b>	<b>2,1</b>	<b>99,1</b>	<b>99,1</b>	<b>99,1</b>	<b>99,1</b>	<b>99,1</b>	<b>99,1</b>	<b>99,1</b>	<b>99,1</b>	<b>99,1</b>	<b>99,1</b>	<b>99,1</b>	<b>99,1</b>	<b>99,1</b>
6	<b>Kosto të tjera</b>	<b>4,5</b>	<b>109,6</b>	<b>109,3</b>	<b>110,8</b>	<b>113,0</b>	<b>112,1</b>	<b>111,6</b>	<b>114,5</b>	<b>114,8</b>	<b>113,6</b>	<b>113,2</b>	<b>113,4</b>	<b>116,6</b>	<b>115,8</b>

**Tab. 2. Ndryshimet vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim për Banesa**

Kodi	Grupet	II-17/II-16	III-17/III-16	IV-17/IV-16	I-18/I-17	II-18/II-17	III-18/III-17	IV-18/IV-17	I-19/I-18	II-19/II-18	III-19/III-18	IV-19/IV-18	I-20/I-19	II-20/II-19
	<b>Totali (1+2+3+4+5+6)</b>	<b>0,8</b>	<b>0,5</b>	<b>0,4</b>	<b>0,5</b>	<b>0,5</b>	<b>0,5</b>	<b>1,0</b>	<b>0,4</b>	<b>0,3</b>	<b>0,1</b>	<b>-0,1</b>	<b>0,5</b>	<b>0,4</b>
1	<b>Shpenzime materiale (a+b+c)</b>	<b>1,6</b>	<b>1,3</b>	<b>1,5</b>	<b>0,5</b>	<b>-0,8</b>	<b>-0,6</b>	<b>-0,5</b>	<b>-0,4</b>	<b>-0,3</b>	<b>-1,0</b>	<b>-0,9</b>	<b>-0,6</b>	<b>-1,2</b>
	a. Materiale ndërtimi	2,0	1,7	2,2	1,0	-1,1	-0,7	-0,9	-0,7	-0,4	-1,3	-1,2	-1,0	-1,6
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	0,5	0,7	-0,5	-1,4	-0,1	-1,5	0,0	-0,3	1,0	1,6	1,4	1,4	-0,5
	c. Materiale hidro-sanitare	0,7	-0,2	-1,1	-1,2	0,3	1,1	1,8	1,1	-0,6	-1,2	-1,2	0,1	1,1
2	<b>Shpenzime për paga</b>	<b>2,5</b>	<b>1,6</b>	<b>2,4</b>	<b>1,7</b>	<b>0,6</b>	<b>0,9</b>	<b>1,1</b>	<b>1,3</b>	<b>0,8</b>	<b>1,2</b>	<b>0,5</b>	<b>-0,3</b>	<b>-1,0</b>
3	<b>Shpenzime makinerie</b>	<b>-0,2</b>	<b>-0,3</b>	<b>-0,5</b>	<b>-0,2</b>	<b>-0,3</b>	<b>-0,2</b>	<b>0,6</b>	<b>1,0</b>	<b>0,9</b>	<b>0,7</b>	<b>0,8</b>	<b>0,0</b>	<b>1,0</b>
4	<b>Shpenzime transporti</b>	<b>-1,5</b>	<b>-1,4</b>	<b>-1,9</b>	<b>2,1</b>	<b>2,3</b>	<b>2,5</b>	<b>1,9</b>	<b>-1,0</b>	<b>-0,6</b>	<b>-1,6</b>	<b>0,3</b>	<b>2,1</b>	<b>1,7</b>
5	<b>Shpenzime për energji</b>	<b>0,0</b>	<b>0,0</b>	<b>0,0</b>	<b>0,0</b>	<b>0,0</b>	<b>0,0</b>	<b>0,0</b>	<b>0,0</b>	<b>0,0</b>	<b>0,0</b>	<b>0,0</b>	<b>0,0</b>	<b>0,0</b>
6	<b>Kosto të tjera</b>	<b>2,0</b>	<b>1,8</b>	<b>2,6</b>	<b>1,9</b>	<b>2,2</b>	<b>2,1</b>	<b>3,3</b>	<b>1,6</b>	<b>1,4</b>	<b>1,4</b>	<b>-0,9</b>	<b>1,6</b>	<b>1,9</b>

**Tab. 3 . Ndryshimet tremujore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim për Banesa**

Kodi	Grupet	II-17/I-17	III-17/II-17	IV-17/III-17	I-18/IV-17	II-18/I-18	III-18/II-18	IV-18/III-18	I-19/IV-18	II-19/I-19	III-19/II-19	IV-19/III-19	I-20/IV-19	II-20/I-20
	<b>Totali (1+2+3+4+5+6)</b>	0,1	0,1	0,1	0,2	0,1	0,1	0,6	-0,3	-0,01	-0,1	0,4	0,2	-0,1
<b>1</b>	<b>Shpenzime materiale (a+b+c)</b>	1,0	0,2	-0,1	-0,6	-0,3	0,5	0,0	-0,5	-0,2	-0,2	0,0	-0,3	-0,7
	a. Materiale ndërtimi	1,5	0,1	0,2	-0,7	-0,7	0,6	-0,1	-0,5	-0,4	-0,3	0,1	-0,3	-1,1
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	-0,9	1,3	-1,2	-0,5	0,3	0,0	0,2	-0,8	1,6	0,5	0,1	-0,8	-0,2
	c. Materiale hidro-sanitare	-0,1	-0,3	-0,7	-0,1	1,4	0,5	-0,1	-0,7	-0,3	-0,1	-0,1	0,6	0,7
<b>2</b>	<b>Shpenzime për paga</b>	1,1	0,0	0,9	-0,2	0,0	0,2	1,1	-0,1	-0,4	0,6	0,4	-0,9	-1,1
<b>3</b>	<b>Shpenzime makinerie</b>	0,3	0,0	0,0	-0,5	0,2	0,1	0,8	-0,1	0,0	-0,1	0,9	-0,8	1,0
<b>4</b>	<b>Shpenzime transporti</b>	0,0	0,0	0,2	1,9	0,2	0,1	-0,3	-1,0	0,6	-0,9	1,6	0,8	0,2
<b>5</b>	<b>Shpenzime për energji</b>	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
<b>6</b>	<b>Kosto të tjera</b>	-1,1	-0,3	1,4	2,0	-0,8	-0,4	2,5	0,3	-1,0	-0,4	0,1	2,9	-0,7

# Metodologjia

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) (IKN) mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit, të fuqisë punëtore dhe të shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip (8 – 10 kate). IKN është një tregues i rëndësishëm ekonomik për sektorin e ndërtimit. Indeksi përdoret si deflator për llogaritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Indekseve të ndryshme të volumit, përdoret nga Institucionet Qeveritare, Banka Qendrore e Shqipërisë, Organizata të tjera joqeveritare, Banka Botërore, FMN etj. IKN duke filluar nga tremujori i parë 2011 llogaritet me shportën e re të materialeve. Peshat e këtyre materialeve janë llogaritur duke u bazuar në preventivat e shpenzimeve për ndërtimin e një banese shumëkatëshe marrë nga firmat e ndërtimit. Tremujori i parë i vitit 2011 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (tremujori i parë 2011=100). Shporta e re përbëhet nga 71 zëra nga të cilat 66 janë materiale ndërtimi. Çmimet për materialet e ndërtimit mblidhen nga 166 distributorë dhe shitës me shumicë të materialeve të ndërtimit. Ndërsa, të dhënat për shpenzimet për pagat, makineritë dhe transportin merren nga 94 ndërmarrje të mëdha ndërtimi të përqëndruara kryesisht në rrethin e Tiranës. Zgjedhja e ndërmarrjeve është bërë në bazë të volumit të ndërtimit që ato realizojnë gjatë një periudhe një vjeçare. Shpenzimet janë klasifikuar në përputhje me klasifikimin që përdor EUROSTAT për Indeksin e Kushtimit në Ndërtim, në gjashtë grupe kryesore si më poshtë:

- Shpenzime për materiale
- Shpenzime për paga
- Shpenzime për makineri
- Shpenzime transporti
- Shpenzime për energji
- Shpenzime të tjera

## Rishikimi

Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike, ndryshimi i periudhës bazë etj.

## Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korrent me të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korrent me tremujorin e mëparshëm.